



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE NDJEKJES TË INVESTIMEVE TË INFRASTRUKTURËS

Nr.9480/1 Prot

Shkodër, më 24.07.2020

Lënda: Kthim përgjigje “Kërkesë për informacion”

email: _____

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion me nr.9480prot., datë 07.07.2020 administruar pranë Bashkisë Shkodër ju bëjmë me dije si vijon :

Bashkia Shkodër zbaton projekte bazuar në programe dhe politikat për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit që administron. Referuar traditës shumë vjecare që qyteti i Shkodrës ka në përdorimin e bicikletave dhe me shkëmbimin e eksperiencave më të mira ndërkombëtare, Bashkia Shkodër është partnere në projektin e programit të financimit Horizon 2020 në projektin Park4SUMP. Pedalimi, lëvizja me biçikletë në qytetin e Shkodrës i vlerësuar nga anketimet me rreth 20 - 25% të totalit të lëvizjeve, përbën një aset të vyer të traditës kombëtare, duke ndikuar më se shumti në disiplinimin e trafikut shkaktuar nga mjetet motorrike në qytet.

Përsa i përket pyetjeve të drejtuar nga ana juaj:

- *“A janë korsitë e biçikletave të pajisura me sinjale të ndritshme (fenerë semafori)?*
 - ✓ Bashkia Shkodër sinjalizon korsitë e saja (të biçikletave) me sinjalistikë horizontale dhe vertikale. Cdo investim është realizuar konform legjislacionit në fuqi mbi respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor;
 - ✓ Janë shtuar në qytet vende të parkimit të bicikletave në sheshe rekreative institucione të qytetit etj;
 - ✓ Qytetarët ndjekin respektojnë rregullat e pedalimit në korsitë e përcaktuara dhe të mospedalimit në shëtitoret për këmbësorë, sheshet ose pedonalet në oraret e pikut;
 - ✓ Gjithashtu theksojmë se pedalimi në trotuare nuk është dukuri e zakonshme në qytet, duke mos paraqitur një problematikë serioze.

Në qytetin e Shkodrës nuk ka në funksionim semaforë për disiplinimin e qarkullimit të mjeteve në qytet por trafiku disiplinohet me kryqëzime. Duke qënë se nuk ekziston një sistem i tillë menaxhimi apo disiplinimi të trafikut dhe qarkullimit të mjeteve, do të duhet një investim në të ardhmen për të gjithë rrjetin e rrugëve të qytetit, investim i cili ka nevojë për një mbështetje financiare pasi ka një kosto të konsiderueshme realizimi dhe mirëmbajtje. Ky investim do të duhet të planifikohet dhe projektohet si një projekt afat-gjatë në kuadër të vizionit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Shkodër.

- *A kanë miratuar bashkitë, rregullore në lidhje me organizimin dhe qarkullimin e qytetarëve me biçikleta?*

Bashkia Shkodër ka sot të hartuar një plan mbi mobilitetin e qëndrueshëm në qytet dhe aktivitete ose veprimtari ndërgjegjësuese me qëllim ;

- ✓ Demotivimin i përdorimit të automjeteve si shkaktari kryesor i trafikut në qytet, ndotjes të ajrit dhe rritjes të pasigurisë ose shtimit të aksidenteve në rrugë;
- ✓ Promovimin dhe nxitjen e mënyrave të tjera alternative të lëvizjes drejt lëvizshmërisë të qëndrueshme si ecjes, pedalimit dhe përdorimit të transportit urban;

Në vazhdimësi Bashkia Shkodër po punon në dy plane afat mesme për reduktimin e automjeteve në qytet si më poshtë:

- ✓ Në ridimensionimin e rrugëve, e cili bazohet në “Studimin e Trafikut dhe Lëvizshmërisë për qytetin Shkodër” ku parashikohet ngushtimi i korsive të makinave, përmirësimi i infrastrukturës për bicikleta, dhe reduktimi i vendparkimeve për automjetet;
- ✓ Menaxhimin e parkimeve e cila bazohet në bashkëpunimin në kuadër të Projektit Park4SUMP (Horizon 2020), me të cilën duke u reduktuar vendparkimet e makinave dhe krijimin e hapësirave të reja publike do të shihet mundësia e krijimit të korsive të reja të bicikletave, zgjerimi i trotuareve, deri tek iniciativat e reja të parkimeve me pagesë në qytet. Këto plan veprime do të ulin masivisht përdorimin e automjeteve në qytet do të shtojë të ardhurat nga parkimi me pagesë, të ardhura të cilat do të shkojnë në investime konkrete në përmirësimin e transportit publik dhe në nxitjen e përdorimit të metodave të tjera alternative të lëvizshmërisë të qëndrueshme.

Ju falenderojmë dhe ju urojmë punë të mbarë

KRYETAR

Voltana Ademi